

Para se të filloni

- ▶ Qëllimi i kësaj liste kontrolli është të ndihmojë studentët e doktoratës të shkruajnë tezën e tyre dhe ta publikojnë atë në përputhje me normat dhe vlerat e integritetit akademik dhe kërkimor.
- ▶ Lista kontrolluese i ndihmon studentët të përgatisin tezën dhe artikujt e tyre kërkimore shkencore në përputhje me praktikën më të mira kërkimore, të mbështesin sjelljen e përgjegjshme kërkimore dhe të shmangin praktikën e dyshimta kërkimore.
- ▶ Lista kontrolluese duhet të përdoret gjatë gjithë procesit të përgatitjes dhe publikimit të tezës.
- ▶ Kini parasysh se lista mund të duhet të përshtatet me nevojat tuaja në varësi të fushës së kërkimit, përvojës suaj të kaluar dhe në përputhje me politikat institucionale të kërkimit shkencor.

Emri:

Këshilla të përgjithshme

- ▶ Mbani një ditar kërkimor për t'ju ndihmuar të ruani të gjitha informacionet e rëndësishme.
- ▶ Përdorni mjete të përshtatshme për të punuar me burimet e literaturës, për shembull, softuerin e menaxhimit të referencave.
- ▶ Nëse është e mundur, zgjidhni një temë që ju intereson dhe që e kuptoni (ose dëshironi ta kuptoni).
- ▶ Këshillohet që të ndani përvojat tuaja me kolegët e doktoratës, si në fushën tuaj të studimeve ashtu edhe në fushat tjera.
- ▶ Është e rëndësishme për ju që të adaptoheni në fushën tuaj të studimit.
- ▶ Sigurohuni që të ndërveproni me komunitetin e kërkimit, të shkëmbeni ide dhe të merrni pjesë në ngjarje akademike që lidhen me punën ose fushën tuaj të studimit.
- ▶ Jini të vetëdijshëm për kufijtë tuaj dhe mos kini frikë të thoni se ku janë për të parandaluar stërmundimin.

Përgatitjet e parashkrimit

Përgatitje të përgjithshme për mua si student i doktoratës

- Nëse ndonjë nga këto nuk përmbushet, kërkoni këshilla institucionale.
- Kam kontrolluar kërkesat formale të universitetit tim për punën time kërkimore shkencore dhe sipas nevojës, kam ndjekur lëndët e kërkua.
- E di se cilat janë kërkesat për cilësinë e tezës në institucionin tim. Një prej tyre është leximi i tezës së vitit të kaluar.
- E di se ku mund të gjej informacion mbi detyrat dhe procesin e shkrimit të tezës dhe me kë/çfarë duhet të konsultohem nëse kam ndonjë pyetje (p.sh., mentorin bibliotekën e universitetit dhe qendrën e shkrimit).

Integriteti akademik dhe kërkimor

- Kam njohuri për integritetin akademik dhe kërkimor, duke përfshirë shkeljet e ndryshme si angazhimi i një pale të tretë për të kompletuar detyrat, mullnjtë e punimeve (organizatat që shesin në mënyrë jo etike punimet të studentëve), shtimi i një autori në një punim pa kontribut, plagjiatura dhe çështjet e menaxhimit të të dhënave. Jam i vetëdijshëm për pasojat e pandershmerisë në punën kërkimore shkencore dhe për shkeljet tjera të kodeve institucionale.
- Kam marrë trajnimin e duhur për integritetin akademik dhe kërkimor dhe, nëse jo, kam kontrolluar disponueshmërinë e lëndëve dhe trajnimeve përkatëse në institucionin tim.
- Unë di të gjej dokumente, siç janë kodet e etikës dhe kërkesat institucionale, që janë të nevojshme për kërkimin tim shkencor.
- Mbjaj përgjegjësi personale që teza ime dhe publikimet shkencore do të realizohen duke respektuar integritetin akademik dhe kërkimor.

Përgatitjet për punën time kërkimore shkencore

- Unë dhe mentorin im kemi caktuar një orar të përshtatshëm pune, kemi rënë dakord për takime individuale ose grupore dhe për afatin kohor që do të ndjek.
- Unë dhe mbikëqyrësi im kemi diskutuar se si dhe kur mund të kontaktoj me të; ne kemi rënë dakord të respektojmë orarin e punës së njëri-tjetrit dhe të shmangim kontaktet me njëri-tjetrin gjatë fundjavave dhe gjatë pushimeve.

- Kam kontrolluar se çfarë lelesh më nevojiten për punën time kërkimore (p.sh., leje për të përdorur instrumente matëse dhe të dhëna ekzistuese dhe për të kryer aktivitete hulumtuese në një organizatë).
- Kam kontrolluar me mentorin tim nëse kërkimi im shkencor kërkon miratim etik.
- Kam kontrolluar kërkesat për trajtimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e të dhënave që nevojiten për punën time kërkimore (p.sh. Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave - GDPR).

Në proces e sipër

Formulimi i pyetjeve kërkimore dhe dizajni i studimit

- Më është miratuar tema e tezës nga mentori im.
- E di se si teza ime do të japë një kontribut që e dallon atë nga puna e mëparshme.
- E kuptoj detyrën dhe e di se cili është qëllimi i tezës dhe si ta arrij atë.
- Unë dhe mentori im kemi diskutuar dhe kemi rënë dakord për qëllimin e hulumtimit tim shkencor si dhe për njohuritë dhe/ose aftësitë e nevojshme për të zbatuar dizajnin e kërkimit shkencor.
- Jam i bindur se kam aftësitë e nevojshme për të zbatuar dizajnin e kërkimit shkencor.
- Kemi folur me mbikëqyrësin tim për konfliktet e mundshme të interesit.
- E kam hartuar me kujdes metodologjinë e kërkimit që të korrespondojë me pyetjet e mia kërkimore shkencore dhe e kam diskutuar me mbikëqyrësin tim përpara se të filloj të shkruaj.

Hulumtimi shkencor

Mbledhja e të dhënave

- Unë dhe mentori im kemi diskutuar mënyrat e duhura të mbledhjes, regjistrimit dhe menaxhimit të të dhënave të kërkimit dhe kemi rënë dakord se si do të kryhen këto detyra në kërkimin tim shkencor.
- Unë dhe mentori im kemi folur për rëndësinë e mbajtjes së protokolleve të mira kërkimore (respektivisht shënimeve të kërkimit) dhe kemi rënë dakord për formën e tyre.
- Unë dhe mentori im kemi biseduar për aspektet e etikës së kërkimit që lidhen me punën time, siç është rëndësia e pëlqimit të informuar, dhe kemi rënë dakord se si do të sigurohen parimet e etikës së kërkimit në punimin tim.

Përpunimi dhe analiza e të dhënave

- Unë dhe mentori im kemi rënë dakord për metodat e përpunimit dhe analizës së të dhënave që do të përdor.
- Jam i vetëdijshëm për faktorët që mund të ndikojnë në objektivitetin në analizën e të dhënave, siç janë format e ndryshme të paragjyqimeve ose konflikti i interesit.
- Jam i vetëdijshëm se të gjitha kufizimet e mundshme, paragjyqimet dhe konfliktet e interesit duhet të deklarohen qartë në punimin tim.
- Jam në dijeni të kërkesave institucionale dhe ligjore për ruajtjen e duhur të të dhënave të kërkimit dhe kam rënë dakord se si dhe ku do të ruhen të dhënat e mia.
- Jam i vetëdijshëm për mundësinë e përjashtimit dhe pse dhe si ato nuk duhet të hiqen nga baza e të dhënave.
- Nëse ka nevojë për të anonimizuar të dhënat e mbledhura, unë do të krijoj kode dhe do të bëj anonimizimin përpara se të filloj të shkruaj.
- Është e rëndësishme të anonimizohen pjesëmarrësit në kërkimin shkencor (sipas nevojës); Unë do t'i ruaj kodet e anonimizimit në mënyrën e duhur.

Të lexuarit dhe të shkruarit akademik

Të lexuarit akademik

- Unë di si të bëj një kërkim të literaturës dhe, nëse nuk gjndem, di ku të kërkoj ndihmë, për shembull, në bibliotekën e universitetit.
- Unë përdor burime të literaturës kryesisht nga biblioteka e universitetit ose nga bazat e të dhënave të literaturës multidisiplinare ose shkencore.
- Unë përdor vetëm burime shkencore relevante dhe të besueshme për kërkimin tim.
- Unë kam krijuar një listë leximi për kërkimin tim shkencor.
- Sipas mundësisë, përdor burime parësore dhe shmang burimet dytësore; nëse përdor burime dytësore, do të sigurohem që të verifikoj faktet lidhur me burimet parësore përpara se të shkruaj tezën.
- Mbjaj shënime gjatë leximit dhe përfshij informacion të plotë bibliografik së bashku me shënime të mia.
- Kur lexoj tekste akademike në disiplinën time, i kushtoj vëmendje formës dhe stilit të të shkruarit për të zhvilluar aftësitë e mia akademike të të shkruarit.
- Kam lexuar burime institucionale dhe literaturë të përshtatshme për mënyrën e shkrimit të teksteve akademike.

Puna etike me burimet

- Kam njohuri të mjaftueshme për citimin e duhur (p.sh., citimet në tekst dhe shënime në fusnota) dhe teknikat e referimit.
- Kam kontrolluar se çfarë stili referimi përdoret në institucionin tim, ose kam zgjedhur një të përshtatshëm.
- Kur shkruaj tekstin tim akademik, dalloj qartë tekstin nga burimet (p.sh., citimet dhe materialet e parafrazuara) dhe shkrimin tim origjinal.
- Kam cituar dhe referuar të gjitha burimet e përdorura dhe kam pranuar çdo komunikim personal.
- Unë kam treguar fillimin dhe fundin e të gjitha citimeve të drejtpërdrejta dhe i kam ndjekur ato me citate ose fusnota gjegjëse.
- Kam referuar tekst të parafrazuar ose të përmbledhur.
- Kam përdorur fjalët e mia në vend që thjesht të zëvendësoj fjalët ekzistuese kur parafrazoj një ide.
- Kam treguar siç duhet burimet e të gjitha materialeve të përdorura (p.sh., fotografitë, grafikët dhe tabelat) dhe kam kontrolluar nëse më lejohet t'i përdor ato ose nëse duhet të marr leje.
- Kam etiketuar, numëruar dhe referuar siç duhet të gjithë materialin e përdorur (p.sh., fotografitë, grafikët dhe tabelat,) dhe kam bërë një tabelë të veçantë të përmbajtjes për to.

Struktura, forma dhe gjuha

- Unë e di se çfarë strukture (p.sh., IMRAD) do të përdor në punën time dhe kam rënë dakord për këtë me mentorin tim.
- Në abstrakt, kam shprehur qartë temën e punimit tim dhe kam përshkruar metodologjinë dhe rezultatet e rëndësishme.
- Qëllimi i tezës sime dhe pyetjet e kërkimit janë shprehur qartë në hyrje të tezës sime.
- Teza ime ka një fokus të qartë dhe argumentim të qëndrueshëm, duke përfshirë një lidhje të qartë midis qëllimit të kërkimit shkencor, temave kryesore dhe konkluzionit të përgjithshëm.
- Nuk përfshij informacione të parëndësishme në punimin tim.
- Përdor me saktësi terminologjinë e duhur.
- Përfundimi im është shprehur qartë.
- Ka konsistencë ndërmjet hyrjes dhe përfundimit.
- Gjuha ime është gramatikisht e saktë, e qartë dhe precize.
- Kam përdorur formatimin e kërkuar në abstrakt dhe/ose përmbledhje (sipas nevojës), faqen kryesore, përmbajtjen, numërimin e faqeve, listën e referencës, listën e tabelave/figurave, listën e shkurtesave, etj.

Kur puna juaj është pjesë e një projekti të përbashkët kërkimor shkencor

- Kam diskutuar, kam rënë dakord dhe kam zyrtarizuar detyrat dhe përgjegjësitë e mia individuale dhe të përbashkëta me të gjithë bashkëpunëtorët, në mënyrë që puna bashkëpunuese të jetë e drejtë dhe transparente.
- Kam diskutuar, kam rënë dakord dhe kam zyrtarizuar marrëdhëniet ndërmjet projektit dhe punës sime për sa i përket autorësisë.
- Kam diskutuar, kam rënë dakord dhe kam zyrtarizuar marrëdhëniet ndërmjet projektit dhe punës sime për sa i përket përdorimit të të dhënave.
- Kam diskutuar, kam rënë dakord dhe kam zyrtarizuar marrëdhëniet ndërmjet projektit dhe punës sime për sa i përket të drejtave të pronësisë intelektuale.
- Jam siguruar që të kem të gjitha miratimet etike të kërkuara për studimin përpara se të fillojë me punimin.

Publikimi etik

- Kam kontrolluar kërkesat e botuesit të mundshëm.
- Kam kontrolluar cilësinë e revistës me bibliotekën e universitetit dhe kemi folur për botuesit mashtrues me mentorin tim. Unë e kuptoj që puna e botuar në një vend të tillë nuk mund të përdoret si pjesë e tezës sime.
- Unë e di se çfarë do të thotë bashkautorësi dhe jam siguruar që të gjithë bashkautorët e listuar në punimin tim kanë kontribuar në punën përgatitore.
- Jam i vetëdijshëm për rëndësinë e renditjes vetëm të atyre që kanë dhënë kontribut përkatës në punim si autorë, siç përcaktohet nga Komiteti Ndërkombëtar i Redaktorëve të Revistave Mjekësore (ICMJE) dhe Komiteti për Etikën e Publikimit (COPE).
- Jam i vetëdijshëm se urdhri i autorësisë duhet të pasqyrojë kontributet përkatëse të individëve.
- Jam i vetëdijshëm se bashkëpunëtorët që nuk kualifikohen si autorë duhet të njihen siç duhet.
- Unë dhe mentori im diskutuam dhe ramë dakord për kontributet e autorëve në artikullin/punimin e përbashkët.
- Unë i respektoj autorët e tjerë dhe kontribuoj mjaftueshëm në punën tonë të përbashkët.
- Jam i vetëdijshëm për nevojën për të zbuluar konfliktet e interesit, nëse ka, dhe për t'i deklaruar hapur ato në publikim.
- Jam i vetëdijshëm se duhet t'ju shpreh mirënjohje atyre që financojnë kërkimin shkencor.

Konsideratat përfundimtare

- Kam referuar burimet e mia në mënyrë transparente.
- Kam përdorur një stil referimi vazhdimisht.
- Kam kontrolluar dy herë nëse e kam formatuar punën time siç kërkohet.
- E kam kontrolluar dy herë bibliografinë time dhe jam siguruar që ajo përmban të gjitha dhe vetëm burimet e cituara në tezën time/punimin tim kërkimor shkencor.
- E kam lekturuar punimin tim.

Shënime:

.....

.....

.....

.....